

**Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës**  
**Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik**

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **20.12.2023** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)”** i kandidatit **Mr. Beqir Memeti**.

Në bazë të Vendimit **16-961/1** të datës **20.12.2023** dhe Vendimit nr. **16-205/2** të datës **16.04.2024**, Komisioni i përbërë nga: **Prof.dr. Adnan Ismaili** (kryetar), **Prof.dr. Sulejman Baki**, **Prof.dr. Fehari Ramadani**, **Prof.dr. Kushtrim Ahmeti** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Metin Izeti** (mentor), pasi analizoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

**RAPORT**

*për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës*

**Të dhënat biografike për kandidatin**

Beqir Memeti, ka lindur më 04.03.1976, fshati Xhepçisht- Tetovë. Shkollën fillore e ka kryer në fshatin e lindjes, ndërsa shkollën e mesme në Medresenë “Isa Beu”, në Shkup. Studimet e para deridiplomike i ka kryer në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup. Studimet pasdiplomike i vijoi në Fakultetin Filozofik të Universitetin e Tetovës program studimor: Filologji orientale, drejtimi Gjuhë dhe letërsi arabe, ku edhe e mbrojti temën e magjistraturës: **“Publicistika e Haki Sharofit”**. Studimet e doktoraturës i filloi në vitin akademik 2018/2019, në Fakultetin Filozofik të Universitetin e Tetovës, program studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale. Nga shtatori i vitit 2020 është i angazhuar si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, programi studimor Filologji orientale. Beqir Memeti ka të botuara disa punime shkencore në revista të ndryshme shkencore dhe ka marrë pjesë në numër të caktuar të konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit.

### Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës

Kandidati Mr. Beqir Memeti që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Monografia:

1. Beqir Memeti, *Horizontet publicistike të Haki Sharofit*, Tetovë, 2021.

Punimet shkencore:

1. Beqir Memeti, **Currents of philosophical thought and intellectual debates in Albania (1918-1939)**, in: PHILOSOPHICA, v. 10, no. 19-20.
2. Beqir Memeti, *Revista Zani i Naltë- zëdhënës i mendimit intelektual musliman*, në: Albanologjia, v. 10, nr. 19-20.

### Analizë e disertacionit të doktoraturës

Disertacioni i doktoraturës me titull: *“Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)”* i kandidatit **Mr. Beqir Memeti** përbëhet nga Hyrja, tre kapituj, një analizë e përgjithshme, Përfundimi dhe Bibliografia.

Në pjesën e **Hyrjes** kandidati i diskuton njohuritë paraprake dhe përgaditëse për zhvillimin e mendimit shqiptarë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, më drejtë nga pavarësia e deri në fillimet e luftës së dytë botërore. Lëvizja Kombëtare Shqiptare, thekson kandidati, nuk u shpreh vetëm me luftën e përditshme politike, diplomatike e ushtarake për mbrojtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Ajo u shfaq në të njëjtën kohë edhe me zhvillimin e vullshëm të mendimit politik, filozofik e shoqëror, si edhe të veprimtarisë publicistike, letrare e shkencore. Një vend qendror në platformën ideologjike, zuri koncepti filozofik për kombin. Rilindasit nuk u pajtuan me konceptin që një popull quhet komb kur ka formuar shtetin. Konceptin filozofik për kombin e formuloi në mënyrë më të plotë Abdyl Frashëri qysh në pranverën e vitit 1878, ai shikonte si përbërës të një kombi

gjuhën e përbashkët, territorin e përbashkët, historinë e përbashkët dhe jetën shpirtërore të përbashkët dhe mbi të gjitha aspiratën për të formuar një shtet të përbashkët.

Formimi i shtetit shqiptar ishte domosdoshmëri e zhvillimeve historike ndër rajonale, që fillon me shpalljen e Pavarësisë së vendit nga Perandoria Osmane, që në të njëjtën kohë ishte edhe nisma më e madhe e intelektualëve patriotë-atdhetarë e fetarë, si dhe një nga veprat konkrete të teologëve drejt bashkëjetesës fetare të vendosur si kriter i domosdoshëm për ekzistencën e shtetit. Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 dhe me themelimin e shtetit të pavarur shqiptar çështjes së zhvillimit të arsimit iu kushtua rëndësi kryesore. Pjesa më e madhe e firmëtarëve të aktit të Pavarësisë ishin personaliteteve fetare, për dy arsye, së pari si personalitete me influencë në popull dhe së dyti për shkak të arsimit të tyre, edhe pse disa prej tyre ishin të arsimuar për teologji madje ishin teolog të qyteteve përkatëse që gëzonin respekt dhe kishin reputacion të padiskutueshëm në popullsinë shqiptare të kohës.

Megjithëse shumica e shqiptarëve ishin myslimanë, shteti i ri shqiptar nuk miratoi asnjë fe zyrtare dhe shpalli se ndiqte një politikë afetare, ose laike në marrëdhëniet me bashkësitë dhe praktikat fetare të popullsisë.

Në këtë pjesë gjithashtu diksutohen edhe metodat shkencore hulumtuese të cilat janë shfrytëzuar gjatë studimit në fjalë. Gjatë hulumtimit pohohet se janë shfrytëzuar metoda e analizës, sintezës, krahasimit, ndërsa metoda përshkruese për shkak të natyrës së punimit ka gjetur zbatim me të gjerë.

Hipoteza themelore e punimit është: Mendimi oriental dhe oksidental kanë patur ndikim të dukshëm në ndërtimin e mendësisë politike, kulturore dhe intelektuale të shqiptarëve në periudhën pas pavarësisë e deri në luftën e dytë botërore.

Në **Kapitullin e parë**, në kuadër të një numri të konsiderueshëm të nëntitujve diskutohet në hollësi ndikimi i mendimit oriental dhe oksidental në ndërtimin e mendësisë politike, kulturore dhe intelektuale shqiptare në këtë periudhë. Kandidati e analizon mendimin politik, filozofik e shoqëror të rilindjes kombëtare shqiptare, përpjekjet për njësimin e alfabetit dhe hapjen e shkollave të para shqipe, rrethanat shoqërore, arsimoro-fetare dhe kulturore pas pavarësisë së Shqipërisë, rrymat e mendimit filozofik dhe debatet intelektuale, emancipimin si qëllim filozofik të viteve 20-30-ta, historinë e shtypit shqiptar 1920-1924, atmosferën social kulturore në vitet '30-'40, shtypin fetar, në veçanti duke dhënë shembuj konkret nga revistat, "Zani i Naltë", "Kultura islame", "Njeriu", "Hylli i dritës", "L.E.K.A"; më pas shtypin e majtë dhe revistat : "Rilindja", "Bota e RE", "A.B.C", "Përpjekja shqiptare", "Revista letrare", "Bleta", si dhe revistat: "Minerva", "Illyria"; "Jeta dhe kultura", ndërsa në

fund të kapitullit bëhet një analizë në lidhje me ndikimin e pushtetit dhe censures në shtypin dhe jetën kulturore shqiptare.

Në **Kapitullin e dytë**, në hollësi përshkruhet dhe analizohet portreti intelektual dhe letrar i autorëve shqiptarë ndërmjet viteve 1912-1939, më pas kalohet në shembujt konkret të autorëve dhe fenomeneve shoqërore të cilat kanë ndikuar në ndërtimin e mendimit të tyre, si ndikimi i fenomenit të fesë dhe fetarisë si dhe atdheut në krijimtarinë e Hafiz Ali Korçës, mendimi fetar dhe idetë përparimtare në shkrimet e Hafiz Ibrahim Dalliu, Gjergj Fishta, autori që shkroi eposin dhe satirën për të njëjtin popull, Fan Noli, një jetë mes liturgjisë, politikës dhe letërsisë, Migjeni, autori që tregoi mjerimin dhe dhimbje dhe sinqeritet, Haki Sharofi, publicisti i guximshëm dhe redaktori i përgjegjshëm, Krist Maloki, shqiptari me kulturë europiane, mendimi politik i së majtës shqiptare dhe ndikimi i saj në veprimtarinë letrare. Shembujt janë të zgjedhur me vëmendje për të shërbyer si arketipe që do të mund të mbulojnë tërësinë e nënqiellit kulturor dhe mendor të autorëve shqiptarë të kësaj periudhe.

Në **Kapitullin e tretë**, që njëkohësisht e paraqet edhe zbardhjen e idesë gjeneruese dhe themeltare të punimit, diskutohen relacionet orient-oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë ndërmjet viteve 1912-1939, lidhja e orientalizmit dhe ballkanizmit me Ballkanin dhe shqiptarët, ilustrime nga publicistika e Haki Sharofit, më pas disa shembuj të punimeve të kohës që kanë ndikuar në ndërtimin e mendimit shqiptar si Ç'duhet të bajmë?, Misjoni i babe, Rinija kërkon reforma dogmatike, gjithashtu jepen shembuj edhe nga publicistika e Branko Merxhanit, duke paraqitur ilustrime arketipike të veprës së tij nga punimet: "Nga Shqiptarisma në Neo-shqiptarismë", vizioni i Branko Merxhanit, Pse nuk jam marksist?, Liria dashurore, Mjerë populli pa ideale dhe ideologji kombëtare, Apathia (plogështia) e shqiptarit; në vazhdim paraqiten edhe disa shkrime autoriale nga publicistika e autorëve tjerë në "Përpjekja shqiptare", si: Lindorizma shqiptare, Filozofia që na duhet sot, Çështja e gruas në faqet e revistës "Përpjekja shqiptare". Një nga temat e rëndësishme të punimit është edhe statusi i gruas në shoqërinë shqiptare si dhe pozita e saj shoqërore, analizohen tekstet e shkruara në lidhje me feminizmin dhe fatin e gruas shqiptare në të kaluarën dhe në këtë periudhë.

Më pas kandidati bën një **Analizë të përgjithshme**, ku në një mënyrë arrinë të argumentojë dhe konkludojë rezultatin e hipotezës themeltare të tij. Si një komb autokton, konstaton kandidati, shqiptarët janë ende të pozicionuar në një mënyrë specifike midis Orientit Mysliman dhe Perëndimit Evropian, gjë që është, natyrisht, e dukshme në fusha të ndryshme të kulturës shqiptare. Edhe pse gjykimet absolute dhe apodiktike janë gjithmonë të pavlerësuara, ndoshta sot imazhi më i zakonshëm dhe më i njohur autorefleksiv në këtë

kuptim është imazhi i shqiptarëve si komb në udhëkryq, por edhe si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit.

Të dyja këto shfaqje kanë edhe karakter emocional pozitiv edhe negativ, d.m.th. më së shpeshti ato perceptohen si një avantazh i veçantë, por edhe si një fatkeqësi e veçantë e fatit kolektiv shqiptar dhe letërsia luajti një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e tyre në të dyja rastet. Në këtë kuptim, fjala është, pra, edhe për paraqitje letrare specifike me efekte të rëndësishme në sferën joletrare.

Megjithatë, ky imazh aktual shqiptar për veten e tij ka një histori të gjatë dhe komplekse, një histori që i dha formë dhe mund të gjurmohet edhe në të kaluarën letrare, si në letërsinë gojore ashtu edhe në atë të shkruar. Në letërsinë gojore, kuptimi i Orientit Mysliman dhe Perëndimit Evropian u arrit kryesisht në kufijtë e interesit epik për takimin e heroit, herë lindor e herë perëndimor, ku në letërsinë gojore orienti mysliman dhe perëndimi evropian përgjithësisht nuk artikulohej si dukuri reprezentative të pavarura, domethënë nuk realizohen si imagologji të rrumbullakosura qartë, siç ndodh në rrymat e tjera të krijimit letrar. Në fakt, është kryesisht tema rajonale, e kushtëzuar nga fakti historik se Shqipëria, si provinca e Rumelisë Osmane, ka qenë një zonë kufitare mes botës myslimane dhe asaj evropiane për shekuj me radhë, dhe kështu është perceptuar Shqipëria si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Kjo është arsyeja pse marrëdhënia midis Orientit Mysliman dhe Perëndimit Evropian në konceptin social-politik të shqiptarëve është reduktuar në radhë të parë në një konflikt karakteristik epik, me faktin se ka shembuj të shumtë të respektit të ndërsjellë për kundërshtarin si hero në përputhje me një etikë të veçantë epike.

Në letërsinë e shkruar situata është më komplekse. Domethënë, në mënyra dukshëm të ndryshme, Orienti Mysliman dhe Perëndimi Evropian përfytyrohen në letërsinë më të vjetër dhe më të re shqiptare si dy nënsistemet themelore të krijimit konceptual filozofik. Përveç traditës shkrim-letrare të periudhës paraosmane, e cila është më tepër e konceptuar në kuadër të krishterimit, ka edhe një traditë shkruese pikërisht në kuadrin e Shqipërisë osmane, e cila u përfshi plotësisht në praktikën letrare të osmanëve, pra në bashkësinë ndërletrare orientale-islame.

Kjo veçanërisht i referohet krijimit letrar të shqiptarëve në gjuhët orientale-islame, turqisht, persisht dhe arabisht, që është pjesë e konsiderueshme e trashëgimisë së vjetër letrare shqiptare, kështu që orienti mysliman ishte jo vetëm konteksti i menjëhershëm, por edhe origjinal i shqiptarëve në një periudhë të caktuar. Në fund të fundit, kultura evropiane e viteve të pas luftës së parë botërore e shikonte Shqipërinë në mënyrë identike me këtë kuptim, siç dëshmohet, ndër të tjera, nga koncepti i Lindjes së Mesme, që sipas francezëve

“Proçe-Orient”, në fillim të shekullit u përcaktua nga kufijtë e perandorisë osmane, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Nga ana tjetër, mendësia e re shqiptare është një fenomen që shfaqet në krijimtarinë letrare shqiptare pikërisht në momentin kur Shqipëria pushon zyrtarisht të jetë pjesë e Orientit Mysliman dhe bëhet – ose duhej të bëhej – pjesë e Perëndimit Evropian. Kjo u shkaktua nga shpallja e pavarësisë kur Shqipëria hyri për herë të parë në kuadrin e Evropës Perëndimore pas më shumë se katër shekujve të sundimit osman në këtë vend. Është pra një ndryshim rrënjësor historiko-shoqëror, i cili së shpejti do të ndryshojë rrënjësisht të gjithë Shqipërinë dhe veçanërisht kulturën shqiptare. Si pjesë e këtyre ndryshimeve, fundi i papritur i llojit të kulturës dhe krijimit letrar që karakterizonte kulturën tradicionale shqiptare, pra letërsinë klasike, dhe në kontekstin e krijimit të kulturës moderne shqiptare, lind letërsia më e re, si rrymë e krijimtarisë letrare shqiptare brenda oksidenti do ta ketë fjalën kryesore.

Në këto rrethana, koha e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit të XX-të. koha e konstituimit gradual të letërsisë dhe mendimit të ri shqiptare, e cila shënohet në historinë e kulturës shqiptare Rilindje. Ky proces në letërsinë shqiptare, si dhe kultura shqiptare në përgjithësi, kaloi nëpër periudha të vështira dhe të dhimbshme, dhe karakteristikë e padyshimtë themelore e kësaj kohe ishte një gjendje e dramës kulturore dhe traumës, nga njëra anë, ndërsa, nga ana tjetër, zhvillimi i mendësisë shqiptare në këtë moment u shënuar dukshëm dhe gjendja e vartësisë së saj në raport me modelin e ri të Evropës Perëndimore, dhe më pas lirimi gradual i ndërgjegjes koloniale oksidentale. Kjo është arsyeja pse në këtë proces, vendosmëria e shqiptarëve kundër Orientit Mysliman si kuadri i tyre i dikurshëm ekzistencial dhe Perëndimit Evropian si realiteti i tyre i ri i menjëhershëm jetësor ishte i një rëndësie kyçe.

Në pjesën e **Përfundimit**, kandidati paraqet konkluzat e punimit si dhe hap një dritare paradigmatiche për atë se si është vepruar dhe si duhet vepruar në bashkëkohësinë shqiptare. Nëse një artist nuk i ngërthen burimet ekzistenciale të kombit të tij, thotë autori, nuk do t'i mbetet asgjë për të treguar në artin e tij përveçse të qëndrojë larg kombit të tij. Së paku, kjo do të thotë të largohet nga burimet e veta. Të largohesh nga burimet tua do të thotë të biesh në imitim dhe të bllokosh mundësitë dhe shtigjet e zhvillimit. Një poet me vetëdije historike, thotë Eliot, nuk shpreh vetëm ndërgjegjen e kohës së tij. Për të, e gjithë letërsia që nga Homeri dhe letërsia antike, që duhet konsideruar brenda tij, ekzistojnë në të njëjtën kohë dhe të gjitha këto vepra letrare përbëjnë një trup organik. Ne duhet të jemi po aq të vetëdijshëm për qarqet themeluese të qytetërimit tonë sa edhe për kulturën dhe historinë tonë. Sigurisht, traditë nuk është vetëm emri i asaj që jemi të detyruar të vazhdojmë dhe të mbindërtojmë.

Poeti bashkon një histori të tërë, një kulturë të tërë dhe tekste themeluese të qytetërimit të tij, filtruar dhe ndërtekstualisht, në mënyrë që të lërë një traditë që do ta ndjekin ata që do të vijnë pas tij. Përndryshe, fati i atij që thotë "tradita fillon nga unë" në brezin e ardhshëm do të fshihet.

Duhet thënë qartë se arti jonë nuk do të jetë kurrë në gjendje të prodhojë asgjë origjinale pa e vlerësuar akumulimin e tij historik duke lënë mënjanë të gjitha paragjykimet dhe do të jetë gjithmonë i dënuar të jetë një kopje. Por fragmentimi aktual dhe ndarjet ideologjike sugjerojnë se kjo do të jetë e vështirë. Vetëm për shkak se është e vështirë nuk do të thotë se nuk do të jetë e pamundur. Këtë duhet ta arrijmë, përndryshe nuk do të kemi asnjë vlerë artistike për t'i lënë historisë diçka nga arti jonë bashkëkohor.

Në pjesën e **Bibliografisë** janë rradhitura në bazë të rendit alfabetik të gjitha burimet dhe literature e konsultuar nga ana e kandidatit.

### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura**

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull "*Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)*", kandidati është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si, përshkrimi, analiza, krahasimi dhe kritikizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëra-tjetrën.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht burimet autoriale të autorëve shqiptarë, dokumente të botuara, monografi, zëra enciklopedikë, punime shkencore nga revista të ndryshme, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën shqipe etj.

Përshkrimet, analizat, krahasimet dhe kritikatat janë bërë në bazë të metodologjisë së mirëfilltë shkencore dhe si rrjedhojë mund të shërbejnë si një dokument dhe provë e veçantë në punimet e mëtejshme për temën në fjalë.

### Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Rezultatet kryesore të disertacionit të doktoraturës me titull: *“Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)”*, mund të rezimohen si më poshtë:

Paraqitja e konkluzave në bazë të dokumentacionit të analizuar se në periudhën midis dy luftërave botërore, me gjithë prapambetjen ekonomike- shoqërore të Shqipërisë, zhvillimi kulturor bëri hapa përpara dhe ndoqi rrjedhën historike. Falë përpjekjeve të forcave përparimtare e sidomos të inteligjencës në këtë periudhë u krijua një farë klime pluraliste në kulturë.

Neoshqiptarizma i drejtoi të gjitha shigjetat e saj kundër sistemit oriental- lindjes dhe punoi për një Shqipëri oksidentale- perëndimore. Por ajo si armë të saj të vetme shpallte kulturën. Me anë të kulturës duhej të kryheshin të gjitha shndërrimet sociale e politike.

Edhe pse Perandoria Osmane ishte larguar, problematik për ta mbetej vazhdimi i ndikimit të “Orientit” përmes fesë islame, diçka që nuk mund të tolerohej ndërkohë që Shqipëria kërkonte të bënte pjesë në kulturën dhe qytetërimin evropian. Për pasojë u morën masa që simbolika e islamit të përjashtohej nga sfera publike, veçanërisht në shkolla dhe institucione shtetërore. Polemikët e tyre me ulemanë muslimanë ashpërsohej sidomos kur diskutohej zbulimi i fytyrës së grave myslimane në publik. Përgjithësisht, reformat e ndryshme që u kryen nga shteti në Shqipëri për ndryshimin e strukturës politiko-juridike dhe për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e shoqërisë borgjeze u kuptuan drejt nga komuniteti musliman dhe u përkrahën.

Përveç institucioneve shtetërore, trysnia për të reformuar praktikën dhe institucionet myslimane vinte edhe nga intelektualët laikë, të cilët përmes shtypit paraqisnin vizionet e tyre të Shqipërisë “oksidentale” dhe kritiknin tiparet “orientale” të shoqërisë. Sipas tyre, ëndrrat e reja, që kishin shqiptarët për të ardhmen e tyre, kërkonin në radhë të parë, që të gjithë të ngriheshin në lartësinë e detyrës së re historike dhe të respektonin evolucionin, që u impononte koha, e njëkohësisht të plotësonin “boshllëqet” e trashëguara nga e kaluara.

Është bërë analizë e thuktë e organeve të shtypit (revistat dhe gazetat) të cilat janë ndarë në tri grupe kryesore, duke marrë për bazë përcaktimin e tyre. Në grupin e parë bënë pjesë shtypi fetar, ku është dhënë një psqyrë koncize mbi historikun, politikën redaktuese dhe përmbajtjen e revistave islame “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, “Njeriu” si dhe dy revistat e komunitetit katolik “Hylli i Dritës” dhe “L.E.K.A”.

Për shkak të jetëgjatësisë dhe rolit të tyre për revistat “Zani i Naltë” dhe “Hylli i Dritës” ka më shumë të dhëna. Në grupin e dytë bëjnë revistat që kanë pasur politikë redaktuese dhe



orientim politik të majtë, siç ishin revistat “Rilindja”, “Bota e re”, “A.B.C”, “Përpyekja shqiptare”, “Revista letrare”, “Bleta”. Në grupin e tretë bëjnë pjesë revistat që nuk kishin përcaktim të lirë dhe kryesisht botonin shkrime nga fusha e kulturës dhe letërsisë, këtu bënin pjesë revistat: “Minerva”, “Illyria”, “Jeta dhe kultura”.

Në të gjitha këto revista autorët shqiptarë të kohës kanë botuar shkrimet e tyre për shumë çështje të ndryshme, në mesin e të cilave edhe për relacionet e orientit dhe oksidentit.

Ashtu siç janë analizuar dhe pasqyruar organet me të rëndësishme të shtypit shqiptar ndërmjet dy luftërave botërore, përkatësisht gjatë periudhës së viteve 1912-1939, njëjtë edhe për autorët me të shquar shqiptar është dhënë pasqyrë mbi jetën, veprimtarinë si dhe shkrimet e tyre për relacionet orient- oksident. Përzgjedhja e autorëve ka qënë e vështirë që të jetë sa më objektive. Janë përzgjedhur autorë nga krahina dhe besime të ndryshme, që në mes tyre kanë pikëtakime dhe divergjenca. Autorët që janë analizuar dhe pasqyruar janë: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Gjergj Fishta, Fan Noli, Migjeni, Haki Sharofi dhe Krist Maloki.

Po ashtu në formë të sintetizuar janë dhënë edhe pikëpamjet e autorëve me bindje politike të majtë, ku kemi veçuar Haki Stërmillin, Sterejo Spase, Nonda Bulka dhe Musine Kokalari.

Rasti i Shqipërisë midis dy luftërave botërore është domethënës për të studiuar kuptimet e “Evropës” në proceset komb-formuese në periferinë e kontinentit. Elitat politike dhe kulturore të shteteve të rinj kombëtarë shikonin për nga Evropa Perëndimore për të siguruar legjitimitet, frymëzim moral, udhëzime si edhe ndihmë materiale për modernizim.

Gjithashtu janë dhënë shkrime arketipike ku janë të pasqyruara problemet kryesore të shoqërisë shqiptare gjatë periudhës së viteve 1912-1939. Fokusi ka qënë përzgjedhja e shkrimeve ku do të mund të nxjirren në sipërfaqe pikëpamjet e autorëve shqiptar rreth relacioneve orient- oksident, thenë ndryshe ruajtjen/largimin dhe pranimin/refuzimin e trashëgimisë së përgjithshme të kaluarës. Shkrimet, kryesisht publicistike janë ndarë në katër grupe kryesore, edhe atë: Publicistika e Haki Sharofit, Publicistika e Branko Merxhanit, Shkrimet e autorëve tjerë në revistën “Përpyekja shqiptare” dhe Çështja e gruas në faqet e revistës “Përpyekja shqiptare”. Shumica e shkrimeve janë marrë për studim nga revista “Përpyekja shqiptare”, si njëra ndër organet kryesore dhe me më ndikim në mendimin shqiptar gjatë viteve 1912-1939.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit**

Disa nga nëntitujt e këtij disertacioni mund të jenë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rëndësia e këtij disertacioni është përmbledhja dhe analiza e shkrimeve dhe veprimtarisë politike, kulturore dhe shoqërore fetare të autorëve shqiptarë. Si rrjedhojë, prej ku edhe mund të del një pasqyrë e qartë për ndikimet dhe mënyrën e mendimit dhe veprimit shqiptar ndërmjet viteve 1912-1939.

Përmes shfrytëzimit të dokumentacionit origjinal nga revistat, dokumenteve të botuara dhe të njohura pjesërisht, shfrytëzimit revistave dhe literaturës relevante, punimeve dhe monografive në gjuhën shqipe për historikun dhe zhvillimin e mendimit shqiptar në këtë periudhë, kandidati ka sjellë prurje të reja shkencore, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar në fushën e historisë dhe filologjisë dhe me theks të veçantë për kulturologjinë dhe studimet orientale në hapësirën shqiptare.

Rendësi të veçantë nga të gjitha çështjet të cilat i ka shqyrtuar kandidati në punimet e përzgjedhura i ka kushtuar prezencës së ideve orientale apo oksidentale në mesin e autorëve shqiptarë, qoftë ato me prapavijë fetare, laike apo edhe me ide komuniste.

Kjo krejt me dëshirë që të deshifrohet realisht dhe pa devijime ideologjike apo edhe grupe i prezencës por edhe rolit dhe pozicionit të ideve orientale dhe oksidentale në jetën politike, arsimore, fetare dhe kulturore të shqiptarëve.

Si përfundim, vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut të rëndësishëm në pasqyrimin e pasurisë intelektuale dhe kulturore në përgjithësi në historinë e mendimit shqiptar si dhe në antropologjinë kulturore të shqiptarëve në përgjithësi në trojet shqiptare.

### **Hulumtime të mundshme të ardhshme**

Disertacioni i doktoraturës *“Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)”*, është temë e përgjithshme dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.

Kandidati është munduar që për të gjitha idetë dhe mendimet e kësaj periudhe të jep sqarime plotësuese të cilat mund shërbejnë për njohuri të reja jo vetëm në fushën e kulturës dhe letërsisë por edhe të historiografisë shqiptare.





Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për zbardhjen e historisë dhe kulturës së mirëfilltë dhe reale shqiptare, që janë të pakta dhe si rrjedhojë pak të njohura dhe mund të shërbejnë për zgjerimin dhe thellimin e studimeve të ardhshme. Veçanërisht analiza e

përgjithshme e kandidatit paraqet një shtytës efektiv për kahjen e zhvillimit të studimeve të periduhës në fjalë.

### **Vlerësim dhe rekomandim**

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës *“Relacionet orient- oksident në veprimtarinë e autorëve shqiptarë (1912-1939)”*, të kandidatit Mr. Beqir Memeti, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

### **Komisioni recenzues:**

1. Prof. Dr. Adnan Ismaili (Kryetar) 
2. Prof. Dr. Sulejman Baki (anëtar) 
3. Prof. Dr. Fehari Ramadani (anëtar) 
4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti (anëtar) 
5. Prof. Dr. Metin Izeti (Mentor) 

Tetovë, 13.05.2024